

## **VENDIM**

**Nr. 58, Datë 29.01.2004**

### **PËR ORGANIZIMIN E DREJTORISË SË SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të nenit 25, të ligjit Nr. 8457, Datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar "Sekret Shtetëror"", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

#### **VENDOSI:**

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), është person juridik, buxhetor, shtetëror, në varësi të Kryeministrit.
2. Veprimtaria dhe detyrat e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, përcaktohen në ligjin organik.
3. Struktura dhe organika e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratohen nga Kryeministri.
4. Për nëpunësit e kësaj drejtorie zbatohet legjislacioni për shërbimin civil, ndërsa për punonjësit e tjerë, zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.
5. Buxheti i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, përbën zë të veçantë në buxhetin e Kryeministrit.
6. Pagat e nëpunësve të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, përcaktohen sipas lidhjes Nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, ndërsa punonjësit e tjerë paguhen sipas lidhjes II-5, të vendimit Nr. 726, Datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", të ndryshuar.
7. Funkcionimi i brendshëm bëhet sipas rregullores përkatëse, miratuar nga Kryeministri.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**FATOS NANO**

**LIDHJA NR. 1**

KLASA	EMËRTIMI	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore për Vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
II-a	Drejtör	9.000	2%	0	90.000
III -b	Përgjegjës Sektori	9.000	2%	0	40.000
IV-a	Specialist	9.000	2%	0	30.000
IV-b	Specialist	9.000	2%	0	20.000